

Noftim për vend pune si “**Specialist për çështjet ligjore**”
pranë **Strukturës Mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike**

Bordi i Mbikëqyrjes Publike njofton vend të lirë pune në pozicionin “**Specialist për çështjet ligjore**”. Kandidati duhet të plotësojë kriteret si në vijim:

- a. Të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
- b. Të ketë zotësi për të vepruar;
- c. Të ketë përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel në fushën e jurisprudencës, si dhe të ketë përvojë pune të paktën 2 vite në fushën përkatëse.
- d. Të mos jenë marrë ndaj tij/saj masa disiplinore të largimit nga puna për shkak të një shkelje të rëndë disiplinore;
- e. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë;
- f. Të zotërojë gjuhën Angleze në nivel të pranueshëm dhe të përshtatshëm për punën.

Kandidati të shprehë interes brenda datës **14 shtator 2018** në adresën info@bmp.al duke dërguar dokumentet si në vijim:

1. CV;
2. Letër motivimi;
3. Fotokopje të kartës së identitetit;
4. Letër rekomandimi (nga punëdhënës ose pedagogë);
5. Kopje të noterizuar të diplomës dhe certifikatave, ku të ketë përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel në profilet përkatëse të fushës së jurisprudencës.
6. Vërtetim se ka të paktën 2 vite përvojë profesionale në fushën e mësipërme (si vërtetim mund të shërbejnë fotokopje e noterizuar e librezës së punës, ose vërtetim nga sigurimet shoqërorë për gjendjen e sigurimit shoqëror e shëndetësor, ose vërtetime të tjera të cilat provojnë kriterin ligjor të përvojës në punë).
7. Dëshmi të gjendjes personale gjyqësore (dëshmi penaliteti) të 3 muajve të fundit (në mungesë të saj vetëdeklarim dhe dorëzimin e dëshmisë deri në lidhjen e marrëdhënieve të punës).
8. Dëshmi që provon se ka njohuri të gjuhës angleze (si dëshmi mund të shërbejnë certifikatat kombëtare ose ndërkombëtare për gjuhën angleze, ose diploma apo dëshmi të ndjekjse së një programi studimor në gjuhën angleze, ose dëshmi nga punëdhënësi që mjedisi i punës dhe aktiviteti i punëdhënësit është zhvilluar në gjuhën angleze).